

AKTGJYKIMET E SHPALLURA PËR KRIMET E LUFTËS GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2025

BULETIN | SHTATOR 2025

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë, monitoron proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave të Kosovës. FDHK, në vazhdimësi, ka publikuar dhe do të publikojë analiza të rasteve dhe buletine, që do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi këto procese gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informacionet për shtatë (7) raste të krimeve të luftës në Kosovë, për të cilat janë shpallur aktgjykimet në shkallën e parë pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština dhe aktgjykimet në shkallën e dytë pranë Departamentit Special të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, gjatë periudhës janar - qershor 2025.

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština janë shpallur aktgjykimet në shkallën e parë në pesë (5) raste: **Prokurori kundër Dragisha Millenkoviqit, Prokurori kundër Çasllav Jolliqit, Prokurori kundër Zoran Vukotiçit (rastet e bashkuara), Prokurori kundër Gavrillo Millosavleviqit dhe Prokurori kundër Zhivojin Neshiqit**. Ndërkaq, një (1) lëndë është kthyer për rigjykim nga Departamenti Special i Gjykatës së Apelit, dhe atë në rastin: **Prokurori kundër Muhamet Alidemajt**, ndërsa në rastin: **Prokurori kundër Ekrem Bajroviqit** është konfirmuar aktgjykimi fajësues i shkallës së parë.

AKTGJYKIMET E SHKALLËS SË PARË TË SHPALLURA PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2025

1. PROKURORI KUNDËR DRAGISHA MILLENKOVIQIT

Më datë 26 dhjetor 2023, prokurori special i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Atdhe Dema, ngriti aktakuzën kundër të pandehurit Dragisha Millenkoviq, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se i pandehuri, gjatë periudhës 24 maj 1999 deri më 10 qershor 1999, në Burgun e Prishtinës/Priština dhe të Lipjanit/Lipljan, në cilësinë e personit zyrtar dhe në bashkëkryerje me zyrtarë të tjerë, në mënyrë sistematike kishte keqtrajtuar të burgosurit shqiptarë, duke i torturuar në mënyrë çnjerëzore me mjete të ndryshme deri në alivanosje; si rezultat i kësaj, u kishte shkaktuar lëndime trupore dhe dhunë psikike.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 27 maj 2024, filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Millenkoviq. Trupi gjykues mbajti gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) seanca të shqyrtimit kryesor, ku u dëgjuan tetëmbëdhjetë (18) dëshmitarë të propozuar nga PSRK.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Kujtim Krasniqi, më datë 16 prill 2025 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Dragisha Millenkoviq u shpall **fajtor** për kryerjen e veprës penale *krim lufte kundër popullatës civile*, i njëjti u dënua me shtatë (7) vite burgim, ndërsa për veprën *mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*, u dënua me një mijë e pesëqind (1,500) euro gjobë.

2. PROKURORI KUNDËR ÇASLLAV JOLLIQIT (RIGJYKIM)

Më datë 18 nëntor 2022, prokurori special i PSRK-së, Ilir Morina, ngriti aktakuzën kundër të pandehurit Çasllav Jolliq, në bazë të dyshimit të bazuar se i pandehuri, gjatë periudhës mars - maj 1998, në fshatin Gjurakoc/Đurakovac të Komunës së Istogut/Istok, në cilësinë e policit, i uniformuar dhe i armatosur, në bashkëkryerje me persona të tjerë, ka marrë pjesë në rrahjen e tre (3) civilëve shqiptarë, me ç'rast ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 28 prill 2023 filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Jolliq. Trupi gjykues mbajti gjithsej dymbëdhjetë (12) seanca të shqyrtimit kryesor dhe u dëgjuan dhjetë (10) dëshmitarë të propozuar nga prokurori i shtetit dhe dy (2) dëshmitarë të propozuar nga ana e mbrojtjes.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Musa Konxheli, më datë 10 qershor 2024 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri u shpall fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës dhe u dënua me tetë (8) vite burgim.

Më datë 29 nëntor 2024, Kolegji i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i kryesuar nga gjyqtari Burim Ademi, mori aktvendim, me të cilin aprovuar si të bazuar ankesën e avokatit mbrojtës kundër aktgjykimit fajësues të shkallës së parë të datës 10 qershor 2024, duke anuluar kështu aktgjykimin e apeluar dhe duke kthyer lëndën për rigjykim.

Pasi lënda u kthye në rigjykim nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më 5 shkurt 2025 filloi shqyrtimi kryesor në rigjykim ndaj të pandehurit Jolliq. Trupi gjykues mbajti gjithsej pesë (5) seanca të shqyrtimit kryesor, ku u ridëgjuan tre (3) të dëmtuar/dëshmitarë, deklaratat e të cilëve, sipas gjetjeve të Kolegjit të Apelit, kishin kundërthënie.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Ngadhnjim Arrni, më datë 30 maj 2025 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Çasllav Jolliq u shpall fajtor për rrahjen e të dëmtuarit Zef Malësia në maj 1998, në lagjen "Bllagaq" të fshatit Gjurakoc/Đurakovac, dhe u dënua me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj. Ndërkaq, për rrahjen e të dëmtuarve Naim Ferati dhe Nexhmedin Curraj, i pandehuri u lirua nga akuzat, pasi për gjykatën nuk u vërtetua se i kishte kryer ato veprime.

3. PROKURORI KUNDËR ZORAN VUKOTIQIT (RASTET E BASHKUARA)

Më datë 22 gusht 2024, kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Rahman Beqiri, mbajti seancën statutore, pas së cilës bashkoi procedurat kundër të pandehurit Zoran Vukotiq për katër (4) aktakuzat e ngritura kundër tij, të gjitha në bazë të dyshimit të bazuar se i pandehuri, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, ka kryer krime lufte kundër popullsisë civile.

Më datë 14 tetor 2024 filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Vukotiq në rastet e bashkuara. Trupi gjykues mbajti gjithsej njëmbëdhjetë (11) seanca të shqyrtimit kryesor, gjashtë (6) prej të cilave kanë qenë të mbyllura për publikun.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Rahman Beqiri, më datë 10 qershor 2025 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Zoran Vukotiq u shpall fajtor vetëm për një pikë të rastit të bashkuar, të rikualifikuar si pika (a), për shkak se gjatë luftës në Kosovë, konkretisht më 18 prill 1999, në afërsi të varrezave të qytetit në Vushtrri/Vučitrn, i pandehuri, në bashkëkryerje me persona të tjerë, në cilësinë e rezervistit të policisë serbe, të veshur me uniformë të policisë serbe dhe të armatosur, e vrau djaloshin shqiptar, të moshës 13 vjeçare, B.M., për të cilin gjykata shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.

Vukotiqi është **liruar** nga akuzat si në vijim:

- Gjatë muajit maj 1999, i pandehuri, në bashkëkryerje me individë të tjerë nga forcat serbe, ka kryer dhunë seksuale ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar, në një fshat të Komunës së Vushtrri/Vučitrn.

- Ndërmjet datave 2 dhe 3 maj 1999, i pandehuri, së bashku me anëtarë të tjerë të forcave serbe, ka marrë pjesë në sulmin ndaj popullatës civile shqiptare që udhëtonte në një autokolonë nga fshatrat Studime e Epërme/Gornja Studimlja në Studime të Poshtme/Donja Studimlja. Gjatë natës, civilët iu nënshtruan keqtrajtimit dhe vrasjeve brutale të trembëdhjetë (13) civilëve: Ekrem Mullaku, Xhavit Mullaku, Fatmir Ahmet Gerxhaliu, Eshref Rashica, Adnan Bunjaku, Rrahmon Ademi, Bajram Gërxhaliu, Avdyl Gërxhaliu, Bahrije Gërxhaliu, një djalë 14-vjeçar i paidentifikuar, si dhe Haki Ademi, Shaip Gerxhaliu dhe Musa Gërxhaliu.
- Më 5 maj 1999, i pandehuri, së bashku me anëtarë të tjerë të forcave serbe, ka marrë pjesë në rrahjen dhe plaçkitjen e civilëve shqiptarë, si dhe në vrasjen e Enver Rustollit, Hamdi Fazliut, Avdulla Fazliut dhe Fahredin Fazliut, si dhe në torturimin dhe plaçkitjen e civilëve shqiptarë të tjerë në Vushtrri/Vučitrn.

4. PROKURORI KUNDËR GAVRILLO MILLOSAVLEVIQIT

Më datë 29 nëntor 2023, prokurori special i PSRK-së, Ilir Morina, ngriti aktakuzën kundër të pandehurit Gavrillo Millosavleviq, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se i pandehuri, gjatë periudhës 22–24 maj 1999, në Burgun e Dubravës/Dubrava, në bashkëkryerje me gardianë të tjerë të burgut, të burgosur serbë dhe me njësitë speciale policore dhe ushtarake, kishte kryer vrasje masive të të burgosurve shqiptarë, si pasojë e së cilës mbetën të vrarë 109 të burgosur dhe 108 janë plagosur. Po ashtu, sipas aktakuzës, gjatë periudhës 1998–1999, i pandehuri, në bashkëkryerje me forcat serbe, ka marrë pjesë në rrahjen, maltretimin, torturat dhe keqtrajtimin e të burgosurve shqiptarë.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 11 shtator 2024 filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Millosavleviq. Trupi gjykues mbajti gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) seanca të shqyrtimit kryesor, ku u dëgjuan njëmbëdhjetë (11) dëshmitarë të propozuar nga PSRK dhe dy (2) dëshmitarë të propozuar nga ana e mbrojtjes.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Vesel Ismaili, më datë 16 qershor 2025 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Gavrillo Millosavleviq **u lirua** nga të gjitha pikat e aktakuzës për veprën penale *krime lufte kundër popullsisë civile*, për arsye se nuk u provua se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykata nuk konteston faktin se ka ndodhur Masakra në Burgun e Dubravës/Dubrava ndaj të burgosurve shqiptarë, mirëpo nuk u arrit të vërtetohet se i pandehuri, i uniformuar dhe i armatosur, ka gjuajtur me armë zjarri në drejtim të të burgosurve shqiptarë.

5. PROKURORI KUNDËR ZHIVOJIN NESHIQIT

Më datë 26 gusht 2024, prokurorja speciale e PSRK-së, Florie Salihu Shamolli, ngriti aktakuzën kundër të pandehurit Zhivojin Neshiq, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se i pandehuri, gjatë muajit prill 1999, në një fshat të Komunës së Vushtrrisë/Vučitrn, si pjesëtar i njësisë rezervë të forcave policore serbe, në bashkëkryerje me dy (2) pjesëtarë të tjerë të këtij njësi, kishte kryer *dhunim seksual si krim lufte kundër popullsisë civile*, ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 18 dhjetor 2024 filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Neshiq. Trupi gjykues mbajti gjithsej tetë (8) seanca të shqyrtimit kryesor, të cilat ishin të mbyllura për publikun.

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priştina, i kryesuar nga gjyqtarja Violeta Namani Hajra, më datë 17 qershor 2025 shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Zhivojin Neshiq u shpall **fajtor**, pasi me përdorimin e dhunës fizike, psikike dhe veprimeve tejet çnjerëzore kishte kryer dhunim seksual ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar. Gjykata për këto veprime shqiptoi **dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **pesëmbëdhjetë (15) vitesh**.

AKTGJYKIMET E SHKALLËS SË DYTË TË SHPALLURA PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2025

6. PROKURORI KUNDËR MUHAMET ALIDEMAJT

Më datë 29 mars 2022, prokurori special i PSRK-së, Ilir Morina, ngriti aktakuzë kundër të pandehurit Muhamet Alidemaj, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se i pandehuri, më 28 mars 1999, në fshatin Izbicë/Izbica të Komunës së Skënderajit/Srbica, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave ushtarake dhe policore serbe, kishte marrë pjesë në trajtimin çnjerëzor, cënimin e integritetit trupor dhe të shëndetit, grabitjen dhe shkatërrimin e pasurisë së popullatës civile shqiptare në Izbicë/Izbica dhe fshatrat përreth, të cilët i kishin dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe, nën kërcënimin e armës, i kishin grumbulluar në një livadh në mes të fshatit. I pandehuri, në po të njëjtën datë, në vendin e njohur si "Malet e Stejevcit", në bashkëkryerje kishte marrë pjesë dhe kishte kontribuar në vrasjen e 130 civilëve shqiptarë. Dy (2) muaj pas vrasjes së këtyre civilëve, i pandehuri së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe është kthyer sërish në fshat për t'i zhvarrosur kufomat me ekskavator, me qëllim të largimit të tyre në drejtim të panjohur; trupat e të burgosurve u gjetën pas luftës në varrezat masive në Kosovë, me çka ka kryer veprën penale *krime lufte kundër popullsisë civile*.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 28 dhjetor 2022 filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Alidemaj. Trupi gjykues mbajti nëntëmbëdhjetë (19) seanca të shqyrtimit kryesor, ku u dëgjuan shtatëmbëdhjetë (17) dëshmitarë të propozuar nga PSRK, u konstatuan të lexuara deklaratat e tre (3) dëshmitarëve, dhe u dëgjuan katër (4) dëshmitarë të propozuar nga ana e mbrojtjes.

Më datë 12 korrik 2024, trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priştina, i kryesuar nga gjyqtari Vesel Ismaili, shpalli aktgjykimin, me të cilin i pandehuri Muhamet Alidemaj **u shpall fajtor për dy (2) pikat e aktakuzës**, përkatësisht për pjesëmarrje në trajtimin çnjerëzor, cënimin e integritetit trupor dhe të shëndetit, grabitjen dhe shkatërrimin e pasurisë së popullsisë civile shqiptare në Izbicë/Izbica dhe fshatrat përreth, si dhe për pjesëmarrje në vrasjen e 130 civilëve shqiptarë më 28 mars 1999 në vendin e njohur si "Malet e Stejevcit", dhe **u dënua me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim**. Ndërkaq, i pandehuri Alidemaj u lirua nga pika e fundit e aktakuzës, përkatësisht për zhvarrosjen e kufomave.

Kolegji i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit, i kryesuar nga gjyqtari Vaton Durguti, më 23 prill 2025, mori aktvendim me të cilin aprovuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, duke anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe kthyer lëndën për **rigjykim**.

Deri në publikimin e këtij buletini, rigjykimi në këtë lëndë nuk ka filluar.

7. PROKURORI KUNDËR EKREM BAJROVIQIT

Më datë 15 shtator 2023, prokurori special i PSRK-së, Ilir Morina, ngriti aktakuzë kundër të pandehurit Ekrem Bajroviq, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se i pandehuri, më 7 maj 1999, në fshatin Staradran/Starodvorane, kishte marrë pjesë në arrestimin, kidnapimin dhe keqtrajtimin e tetëdhjetë e katër (84) civilëve shqiptarë, të cilët u dërguan në Stacionin Policor në Gjurakoc/Đurkovce, ku u torturuan në mënyrë çnjerëzore dhe iu shkaktuan lëndime të rënda trupore dhe dhunë psikike. Po ashtu, sipas aktakuzës, më 8 maj 1999, në po të njëjtin fshat, në bashkëkryerje me forcat serbe, pas ndalimit të kolonës së civilëve që po udhëtonin drejt Shqipërisë, i kanë plaçkitur, i kanë ndarë meshkujt nga kolona, i kanë dërguar në shtëpinë e D.Z., ku i kanë sulmuar fizikisht, më pas i kanë dërguar në shtëpinë e Z.S. dhe kanë pushkatuar gjashtëmbëdhjetë (16) civilë shqiptarë: Dinë Grabovcin, Hasan Elshanin, Niman Elshanin, Muharrem Elshanin, Muhajedin Elshanin, Shemsedin Elshanin, Nexhmedin Elshanin, Avdyl Elshanin, Ismet Ahmetajn, Mustafë Dreshajn, Berat Dreshajn, Remzi Shalën, Gani Isufin, Bekim Mavrajn, Jeton Ahmetajn dhe Naim Elshani, i cili kishte mbetur i plagosur.

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 24 nëntor 2023, filloi shqyrtimi kryesor ndaj të pandehurit Bajroviq. Trupi gjykues mbajti trembëdhjetë (13) seanca të shqyrtimit kryesor, ku u dëgjuan njëzet (20) dëshmitarë të propozuar nga PSRK.

Më datë 19 korrik 2024, trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, i kryesuar nga gjyqtari Mentor Bajraktari, shpalli aktgjykim **dënues** për të gjitha pikat e aktakuzës dhe të pandehurin e dënoi me dymbëdhjetë (12) vite burgim.

Kolegji i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit, i kryesuar nga gjyqtarja Afërdita Bytyçi, më 21 maj 2025, mori aktgjykimin me të cilin i refuzoi ankesat e avokatëve mbrojtës dhe **konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština**, ku i pandehuri Bajroviq u dënua me dymbëdhjetë (12) vite burgim për krimet e luftës kundër popullatës civile.

GJETJET E FDHK:

Gjatë analizës së aktgjykimeve të shpallura për krimet e luftës në Kosovë për periudhën janar - qershor 2025, vërehet se Departamenti Special i Gjykatës së Apelit po tregon një nivel të lartë në vlerësimin e ankesave të palëve në procedurë, duke reflektuar një qasje të kujdesshme, të arsyetuar dhe të drejtë ndaj çështjeve penale të ndjeshme, siç janë ato për krime lufte.

Nga shqyrtimi i rasteve të evidentuara në këtë buletin, konstatohet se vendimet e shkallës së dytë po krijojnë një standard të mirë dhe praktikë të qëndrueshme në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës në Kosovë. Qasja profesionale, e bazuar në ligj, në prova dhe në të drejtat e palëve në procedurë, e bën Gjykatën e Apelit një instancë kyçe në forcimin e sundimit të ligjit.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga organizata National Endowment for Democracy përmes projektit të quajtur "Përkrahja e drejtësisë tranzicionale, dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e organizatës National Endowment for Democracy (NED).



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD